Carnet de route citoyen

Atelier d'orientation citoyenne

Version : albanais—2021

AUX CENTRES RÉGIONAUX D'INTÉGRATION

DISCRI

DISPOSITIF DE CONCERTATION ET D'APPUI

www.discri.be

Table des matières

Remerciements 3

Logement 4

Soins de santé 14

Travail 24

Commune et CPAS 32

Taxe et tri des déchets 38

Procédures 40

Banque 52

Remerciements

Ont contribué à l'élaboration du Carnet de route citoyen :

Les Centres Régionaux pour l'intégration

Le Sétis wallon pour les traductions

L'asbl Cap Migrants de Liège

L'asbl Harmonie de Mons

Nos remerciements s'adressent spécialement à :

Florin Mircea Patru, stagiaire au Ce·R·A·I·C·, pour sa gracieuse traduction en roumain et Steluta POPA pour la mise à jour en 2021

Aurica USCOV et Inga GELIASHVILI de l'asbl Harmonie, pour leur relecture en russe

Catherine HENROTTE de l'asbl Cap Migrants pour sa contribution à la fiche contrat de travail

Les équipes des CRI et, en particulier Valérie MAUGUIT et Sophie GARAICOCHEA du CRIPEL, Angelica FERULLO du CRIC, Pina LATTUCA, Anne De Vleeschouwer et Claude GIOVANARDI du Ce·R·A·I·C·, Daniel MARTIN, François MAWET, Khalissa EL ABBADI et Inès TAMAZARTI du CRVI

Conception et relecture

Banesa

Për të gjetur një banesë në një sektor privat nuk është e lehtë, në veçanti në disa qendra urbane ku banesat janë më të rralla ose të shtrenjta. Për të marrë një banesë sociale, kushtet janë te rrepta dhe listat e pritjes janë të gjata. Për të gjetur një vendbanim nuk është një punë e vogël!

Për të gjetur nje banesë,

- unë shëtis nëpër lagje në kërkim të afisheve, flas me banuesit e lagjes.
- konsultoj lajmërimet në gazetë dhe në internet,
- regjistrohem në një Agjenci të Mobiljeve Social ose në një Shoqatë të Promovimit Social (me disa kushte)
- regjistrohem në një shoqëri të banesave social ose tek Fondet e familjeve të shumta (me disa kushte).

Shtëpia është një ndërtesë plot e përcaktuar për banimin e një familje.

Apartamenti është tërësia e organizuar e pjesëve në një ndërtesë ose në një shtëpije .

Duplex-i është një banesë me dy kate të bashkuara nga një shkallë e brenshme.

Studjoja është një appartament i vogël. Ajo përfshin një dhomë kryesore më të shumtën e kohës me kuzhinë dhe tualete të ndara.

Kot-i është një dhomë studenti. Në disa kote nuk lejohet të vendosni vendbanimin tuaj kryesor.

Banesa

Lajmërimet janë shpesh hërë të pa plotësurara dhe të vështira për ti lexuar për shkak të shkurtimve. Unë gjej në rubrikën: <<Apartamente me qira>> ose <<Kote dhe studjo me qira>>. Ja disa përkufizime për ta patur më të lehtë.

App. = appartement

C.C. = chambre à coucher

Ch. = chambre

Chauff./ Chf. = chauffage
Chauff.C. = chauffage central

Chde = chaude

Chg.Compr. = charges comprises

Cuis. = cuisine
Cuis.Eq. : cuisine équipée

Dch. = douche

Ds = dans

El. = électricité

Eq. = équipé

Et. = étage

F.O. = feu ouvert

Gar. = garage

Gd/Gde = grand/grande

Hres de vis. = heure de visite

Imméd. = immédiatement

Indiv. = individuel

Jar. = jardin

Lib. = libre

Liv. = living

Mais. = maison

Maz. = mazout

Mblé ent = meublé entièrement

Mens. = mensuel

Mod. = moderne

Parlph = parlophone

Pces =pièces

Pers. : personne

Plac. = placard

Prox.ctr. = à proximité du centre

Poss. = possibilité

Pt. = petit

Px, Prx = prix

Rem. A nf = remis à neuf

Rez/Rdch = rez-de-chaussée

Sàm = salle à manger

Sdb = salle de bain

Stud. = studio

Tél. = téléphone

Terr. = terrasse

Tp. Pl = tapis plain

Tt Cft = tout confort

Wc = toilettes

Exemples :

Appartements Locations	Kots/studio à louer
Namur appt 2 ch cuis.éq.garage terrasse pour couple pas d'animaux 445€ + 65€ prov.chauff. 0496/416.787	Liège à louer spacieux studio appart meublé tt confort calme, état neuf, Prox.ctr 550 € + Chg 04/375.32.16

Quelques sites utiles :

- www.immoweb.be
- www.vlan.be
- www.jannonce.be
- www.pap.be
- www.immozoom.be

Kontrata e Qira-dhënies

Kontrata e qira-dhënies është e domosdoshme. Ajo përmban detyrimisht identitetin e pronarit (qira-dhënies) dhe të qiramarrësit (ai që merr me qira), data e fillimit të kontratës, përcaktimi i të gjërave të dhëna me qira dhe qiraja. Ajo duhet të jetë e regjistruar nga pranari pranë administratës të regjistrimit. Duhet ta lexoni me kujdes përpara se ta nënshruani sepse, një herë e nënshkruar, nuk mundeni të **ndryshoni asgjë**.

Kontrat e qiradhënies mund të ketë një **zgjatje të përcaktuar ose të papërcakturar**. Në rast të ndërprerjes të kontratës, pronari dhe qiramarrësi duhet të respektojnë modalitet e përcaktuara në kontratë (afatin e paralajmërmit , marrëveshjen kategorike,,,) unë lajmëroj në kohë pranarin tim që kam qëllim të dal nga vendbanimin ku jam (shpesh tre muaj përpara ose me disa kushte), me letër rekomande në postë (marr një document që vërteton që letra ime është dërguar në këtë datë).

Pranari duhet të shënojë **çmimin e qirasë dhe shumën e shpenzimeve** të përbashkëta (për shembull, ndriçimi i korridoreve, ashensorat, pastrimi i shkallëve,,,). Përveç qirasë duhet të llogarisni edhe shpenzimet e zakonshme: shpenzimet për nxehjen , dritat, ujin,,,. Disa <u>qira përfshijnë një shumë fikse të para-përcaktuar për shpenzimet sëbashku</u> (shpenzimet janë të përfshira në çminin e qirasë pas marrur parasysh shpenzimet reale) ose një <u>paradhënie e shpenzimeve</u> (është një paradhënie që pranari do të rregullojë çdo trimestër ose çdo vit në bazë të shpenzimeve reale).



Qiraja në të shumtën të kohës, paguhet çdo muaj. Në përgjthësi ajo nuk mund të ndryshohet gjatë zgjatjes të qiradhënies, vëtëm në qoftëse është e parashikuar në kontratë.

Inventari

Inventari i hyrjes është një dokument që përshkruan saktë gjendjen në të cilën gjendet banesa para se të hyj: duhet të shënohen të gjitha anomalitë dhe problement që janë vënë re. Pranari duhet të tregojë që banesa i përgjigjet kërkesave të sigurisë dhe të mbrothësisë (të shëndetit). Qiramarrësi është, përsa i përket atij përgjegjës për dëmet që mund të shkoktojë gjatë qiradhënies (kontratës) por inventari garanton që ai nuk mund të marrë përsipër dëmet e rastit që janë vëne re më përpara.

Inventari duhet të jetë i bashkangjitur në kontratë . për të qenë i vlefshëm, ai duhet të bëhët në praninë e dy palëve, me ndihmën ose jo të një eksperti.

Në këtë rast, shpenzimet e ekspertit mund të shkojnë deri në 15% të çmimit të qirasë.

Në fund të qiradhënies (kontratës) nëse kam shkaktura dëme, duhet ti riparoj vetëm nëse bëhet fjalë për një prishje të quajtur <<normale>> në qoftëse nuk e bëj, pronari mund të përdor krejtësisht ose një pjesë të garancisë të qiramarrësit për të bërë riparimet.

Garancia e qirasë (caution)

Qiramarrësi pathuajse gjithmonë duhet të paguajë një garanci të barazvlershme në një vit, dy ose tre muaj të qirasë. Kjo është një shumë që i jepet pranarit ose një garanci e depozituar në një llogari të bllokuar në bankë në emrin e qirmarrëit (shumë e këshilluar për të shmangur keqkuptimet ose mashtrimet).

Siç e tregon emri, kjo shumë shërben si garanci pranarit në rast të dëmeve të shkaktuara nga qiramarrësi. Këtë shumë e marr në fund të qiradhënies (kontratës) kur invantori i është bërë dhe që banesa është lënë në gjendjen që e kam marrë. Megjithatë, garancia e qiradhënies asnjë rast nuk mund të shërbëjë për të paguar qiratë e papaguara.

Mundem ti kërkoj CPAS-it të vendit tim ku banoj të me japin hua muajin e parë të qirasë dhe shumën e garancisë të qiradhënies nëse kërkesa ime është pranuar, do t'ju a kthej shumën sipas një plani që më është propozuar. Egzistojnë gjithashtu fonde të garancisë të qiromarrjes ose organizma krediti social që mund të intervenojnë.

Unë interesohem në rast nevojë

Ndihmë për mbartjen dhe për qiranë (ADEL)

Kjo është një ndihmë financiare e dhënë nga Valonia për një qiramarrës i cili është i detyruar të lërë banesën e pabanueshme për të banuar në një banesë të përshtatshme. Kjo ndihmë mund t'i jepet edhe një personi të pastrehë kur ai hyn në shtëpi. Kjo ndihmë përbëhet nga një shumë e vetme e cila jepet për shpërnguljen, e plotësuar me një ndihmë shtesë për të kompensuar rritjen e çmimit të qirasë (maksimumi 100 euro / muaj, rritur me 20% për çdo fëmijë në ngarkim).

Modèle de lettre de résiliation de bail

La Louvière, le **25 août 20**..

Monsieur (Madame) X (le nom du propriétaire),

Par la présente, je désire résilier le bail que j'ai signé le 1er janvier 20.. pour la location du studio situé :

Rue St Joseph, 21

7100 Trivières

Studio du 2e étage

Je m'engage à quitter les lieux pour le **31 décembre 20..**

Merci de me contacter rapidement pour fixer un rendez-vous sur place, à votre meilleure convenance. Nous pourrons établir ensemble l'état des lieux et envisager les modalités de remboursement de la caution versée lors de mon entrée dans le logement.

Je vous prie de bien vouloir me signifier votre accord par retour de courrier.

En vous remerciant pour votre aimable collaboration pendant ces années, je vous prie de recevoir, Monsieur (Madame), l'expression de mes salutations distinguées.

M. Dupont

(signature)

Në rast problemi

Nëse qiramarrësi nuk paguan qiranë e tij, pranari mund ti kërkojë gjyqit të paqes ti japën fund kontratës. Në disa raste, qiramarrësi mund të përjashtohet nga banesa.

Kodi civil parashikon që pranari siguron riparimet strukturale që mirëmbajnë banesën në gjendje që të jepet me qira: në mënyrë të përgjithshme, ai merret më riparimet (e mëdhaja). Qiramarrësi siguron riparimet e vogla dhe mirëmbajtjen e banesës gjatë gjithë qiradhënies (kontratës) për shembull pastrimi i oxhakëve, pastrimin e nxehjes të ujit.

Pronari nuk mund të hyjë në banesë pa autorizimin e qiramarrësit, vetëm për riparimet urgjente. Shumica e kontratave të qiradhënieve detyrojnë qirammarrësin të nënshkruajë një sigurim zjarri.

Në të gjitha rastet, është një masë shumë e këshilluar. Në rast probemi të dëmshëm për shendetin , qiramarrësi mund të drejtohet shërbimit të sigurisë dhe të shëndetit publik të komunës së tij ose te Krahina Wallonne.

Diskriminimi në çështje me banesës është i ndaluar dhe i dënuar nga ligji. Megjithatë kjo nuk mund mjafton që ti largojë steriotipet dhe para gjykimet që karakterizojnë disa mentalitete. Pra të kini kujdes të përgatiteni që të përballoheni me situata te tilla.

Kur është vërtetuar një diskriminim, ai mund të denoncohet. UNIA (Qendra Ndërfederale për Shanse të Barabarta) është një shërbim publik i pavarur, misioni ligjor i të cilit është të promovojë barazinë dhe luftën kundër diskriminimit. Ai mund të veprojë në emër të një personi të diskriminuar.Në rast problemi, mund të këshillohem nga shërbimet e tij: linja jeshile falas në numrin e mëposhtëm 0800/12800 ose unia.be unia.be

Banesa Sociale

Shoqata Valone e Banesave menaxhon firmat për banesat e shërbimit publik, pranë të cilave mund të hedh kandidaturën në kushte të caktuara (kushti është: të mos jesh pronar dhe të kesh të ardhura modeste).

Unë hedh kanditaturën time në një (dhe vetëm një) shoqatë të banesave. Vetëm një formular më lejon të drejtoj kërkesen timë komunave të tjera. Regjistri i kanditaturave është i centralizuar dhe trejtimi i tije i regulluar rreptësisht nga Kodi Wallon i banesave që përcakton një seri të kritereve dhe të përparësive.

Për regjistrimin, unë plotësoj formularin dhe e plotësoj me dokumentat e kërkuara:

lajmërimin-ekstraktin e taksave, përbërjen familjare me një historik të tre viteve të fundit, provën e shumës të ardhurave të tatueshme aktuale, vërtetimet të marrjes të ndihmës familiare.

Pavarësisht nga një numër i madh banesash, banesa sociale ka vështirësi t' i përgjigjet numrit të madh të kandidaturave.Listat e pritjes shpesh janë shumë të gjata, prandaj duhet të keni durim.

Agjensia e patundshme sociale

Është një shoqatë që favorizon hyrjen në banesë, duke i ofruar shërbime dhe garanci pronarëve ashtu dhe qiramarrësve. Ajo shërben kështu si ndërmjetëse midis pronarëve që dëshirojnë të jenë të sigurtë dhe qiramarrësve me të ardhura të thjeshta. Ajo propozon një shoqërim të personalizuar të çdo kondidati qiramarrës.

Egzistojnë 28 në Wallonie.

Për tu regjistruar, duhet të plotësoni kushtet e të ardhurave dhe të keni dokumentat e kërkuara.

vërtetimin e të ardhurave, kopjen e kartës të identitëtit, përbërjen familjare, çertificatën e sjelljes së mirë.

Faqja e Shoqërisë Wallone të banesave :

www.swl.be

Për tu informuar për blerjet, qiratë, shpërbimet në Krahinën Wallone

www.wallonie.be/fr/vivre-en-wallonie/habitat-et-energie

Doktori

Eshtë e rëndësishme të zgjidhni një doktor të përgjithshëm të besueshëm pranë shtëpisë tuaj : ai do të jetë « mjeku i familjes » dhe do të mbajë dosjen time mjekësore në rregull. Eshtë e këshilluar të hapni pranë atij atë që ne e quajmë Dosje Mjekësore te Përgjithshme (DMG) që lejon të pakësojë në minimum shpenzimin. Ky mjeku i besimit do të më dërgojë në qoftëse është e nevojshme drejt mjekëve të specializuar.

Nëse kam të njohur që qëdrojmë në të njëjtën lagje, do t'ju kërkoj këshillë.

Nëse nuk njoh person, konsultoj numeratorin telefonik të Komunës time shkronjën D (si Doktor) ose e kërkoj në Internet.

Për një konsultë, shkoj tek kabineti i mjekut sipas orëve që ai më ka informuar ose, nëse nuk mund të shkoj, i kërkoj që të vijë të më konsultojë në shtëpinpë time (atëherë juve paguani një shtesë plus).

Në përgjithësi, çdo mjek organizon konsultat në orë të caktuar ose pret sipas takimeve.

Vetëm në raste urgjente, gjatë fundjavave dhe gjatë natës, unë mund t' i telefonoj një mjeku roje ose të shkoj në një shtëpi mjekësore rojë.Telefonoj në numrin 1733 për të ditur se ku duhet të shkoj. Emrat e mjekëve roje publikohen gjithashtu në gazetën rajonale të shpërndarë çdo javë në kutinë postare, si dhe shërbimet e ndihmës së shpejtë, zjarrfikëses...Duhet ta dini se çmimi i konsultës do të jetë më i lartë, në këtë rast. .

Farmacitë rojë janë gjithashtu të publikuara në gazetë , në faqen e internetit www.pharmacie.be dhe të afishuara në vitrinën e të gjithave farmacive. Ilaçet janë të disponueshme vetëm me recetën e mjekut që vërteton urgjencën.

Vetëm në raste shumë urgjente, mund të shkoj direkt në spital. Një shërbim urgjence është i hapur 24/24.

Mjeku i përgjithsëm është personi i besueshëm që drejton mjekimet e mija dhe siguron ndjekjen. Nëse konsultoj një specialiste, duhet verifikuar përpara pranë "mjekut familjal" që mjekimet janë të ndjekuar mirë. Për shembull, pediatri mund të parashkruajë fëmijës tim një analize gjaku: në këtë rast, unë vetë duhet të marr takim, pastaj të kërkoj që rezultatet ti dërgohen njëkohësisht pediatrit dhe mjekut të përgjithshëm. Në çdo etapë, mundem kështu të kem besim tek"mjeku familjar" për ndjekjen e zhvillimit të ndihmave mjekësore.

Shtëpia mjekësore

Është një vend ku mund të gjej një seri shërbimesh mjekësore të bazës: mjek, infermier(e), gjinekolog(e), fisioterapist(e)... nganjëherë punëtorin social, psikolog (e), dietist(e) ,.. shtëpija mjekësore mund të praktikojë akte të vogla kirurgjike.

Të gjithë personat që janë në rregull me sigurim shëndetësore dhe banojnë në Komunë munden të regjistrohen në një shtëpi mjekësore. Duke u nisur nga regjistimi, konsultat janë tërësisht falas, pas marrë parasysh numrin e vizitave, me kusht që të mos konsultoni mjekë të tjerë (vetëm fund jave ose në raste urgjente).

Nëse nuk jam në rregull me sigurimin shëndetësor, Shtëpija mjekësore mundet të më ndihmojë për plotësimin e dokumentave të nevojshme ose ti kërkojnë CPAS-it të marrin në ngarkim shpenzimet mjekësore urgjente. Shtëpijat mjekësore propozojnë gjithashtu të gjitha llojet e shërbimeve të Solidarësisë Si grupet e fjalës, seancat e informimit...

Për të gjetur shtëpinë mjekësore që është më afër shtëpisë time, unë konsultoj faqen: www.maisonmedicale.org ose në librin telefonik në rubrikën “Maison medicale ” (shtëpija mjekësore) “Centre de Santë” (Qendra e Shëndetit) ou ‘Collectif de Santë” (Kolektivi i Shëndetit).

Planifikimi Familjar

Qendrat et planifikimit familjar presin me mirëbesim të plotë personat që kanë nevojë për këshilla ose ndihma në temë të seksualitetit, të shtatëzanisë, të jetës familjare ose emocionuese. Kujdestaritë janë të organizuara pa takim që orientojnë personat, nëse është e nevojshme, drejt konsultave mjekësore, psikologjike, juridike ose sociale.

Për të gjetur një qendër të planifikimit familjar pranë shtëpisë time, unë konsultoj faqen : www.planning-familial.be ose www.loveattitude.be

Shërbimet e shëndetit mendor

Shërbimet e shëndetit mendor (SSM) mirëpresin çdo person (fëmijë, adoleshentë, të rritur dhe të moshuar) në një situatë shqetësuese (vështirësi bashkëshortore, familjare, shkollore, ankthi, depresioni... etj). Ata ofrojnë konsulta për shërbimet e psikiatrisë, psikiatrisë për fëmijë, psikologjisë, logopedisë dhe konsulta për nga ana psikomotore. Këto konsulta merren në ngarkim nga sigurimi shëndetësor, CPAS (Qendra Publike për Ndihmë Sociale) ose Fedasil (është një institucion që merret me strehimin e të huajve).

Për të gjetur një shërbim të shëndetit mendor, konsultoj faqen e internetit cresam.be ose marr më shumë informacion nga mjeku i familjes.

Ndihma mjekësore urgjente

Një person me qëndrim të parregullt mund të përfitojë ndihma shëndetësore me kusht që një mjek të vërtetojë nevojën e një çertifikate mjekësore. Në këtë rast, unë bëj një kërkesë në CPAS. Ai mund të lëshojë biletat mjekësore ose farmaceutike.

Ai mund të lëshojë një dokument që quhet << réquisitoire >> nëse bëhet fjalë për një intervenim në spital. Në disa situata urgjence që kanë nevojë, shërbimi social i spitalit mund të kontaktohet direkt me CPAS-in.

Administrata e Sigurimeve Shëndetësore

Sigurimi shëndetësor (mutuelle) është një administratë qe kujdeset për paratë e hedhura nga qytetarët që punojnë për të financuar ndihmat shëndetësore eshtë pra solidarësia financiare e të gjithëve që lejon secilin të ketë ndihma të arritshme: të hollat janë të hequra direkt nga rroga ose të ardhurat.

Egzistojnë disa Administrata të sigurimeve shëndetësore (mutualité) që ofrojnë të njëjtat shërbime me disa ndryshime: administrata e sigurimit mjekësor Katolik (mutualité Chrétienne), administrata e sigurimit shëndetësor Socialist (mutualité Socialiste), administrata e sigurimit shëndetësor Liberal (mutualité liberale), administrata e sigurimit shëndetësor asnjanës (mutualité neutre). La CAAMI (Arkë ndihmëse e sigurimit të sëmundjeve dhe invalidave). Unë zgjedh sipas vendit ku e kam shtëpinë dhe afërsitë e mia filozofike.

Shembull: (1) Unë jam sëmurë dhe thërras doktorin. (2) Unë paguaj konsultën. (3) Unë shkoj tek administrata e sigurimit shëndetësor (mutuelle) që do të më kthejë shpenzimet(të hollat).



Konsultimi = +/- 25€

L'inscription

Kur kam një qëndrim të autorizuar më shumë se tre muaj, unë mund të regjistrohem në administratën e sigurimit shëndetësor (mutuelle). Unë shkoj tek administrata e sigurimit shëndetësor (mutuelle) me dokumentat e identitetit.

Unë plotësoj një formular dhe jap dokumentat e kërkuara : kopjen e kartës të identitetit, deklaratën e nderit të disponueshme në administratën komunale, vërtetimin e Komunës që përcakton shtëpinë time, vërtetimin e CPAS-it nëse jam përfitues,…

Pjesa e detyrueshme vjetore

Unë paguaj një pjesë të deyrueshme që varet nga një administratë e sigurimit shëndetësor (mutuelle) në një tjetër (përafërsisht 10€/në vit CAAMI-it dhe 100€/në vit). Atëherë unë jam i titulluar në një administratë të sigurimit shëndetësor (mutuelle) për veten time dhe për personat që kam në ngarkim (bashtëshort (e), fëmijë,..).

Administrata e sigurimit shëndetësor (Mutuelle) propozon gjithashtu një seri të tjera avantagesh me kusht që të paguani një pjesë shtesë. Që nga 1 Janari 2012, kjo pjesë shtesë është e detyrueshme, vetëm me përjashtim të CAAMI-it.

IM = Rimbursimi më i lartë

Nëse varem financiarisht nga ndihma sociale (CPAS), unë përfitoj automatikisht nga rimbursimi më lartë që ekziston (IM). Konsultimet te mjeku, ilaçet dhe transporti publik (tren, autobus, tram dhe metro) janë më të lira. Ka edhe disa ulje çmimi për disa argëtime siç janë pishinat.

Nëse përfitoj nga rimbursimi më i lartë që ekziston, mund të kërkoj që pagesa e kuotës së vogël në ngarkim të pacientit, të zbatohet. Pagesa e kuotës më të paktë që duhet të paguaj do të thotë që kam mundësinë mos paguaj gjithë shumën për disa shërbime të caktuara.Unë paguaj vetëm pjesën që më takon (pjesën time personale) dhe mjeku rimbursohet direkt nga sigurimi shëndetësor.

Nëse familja ime ka të ardhura të pakta, mund të kërkoj atëherë një Rimbursim më të lartë (IM).

Për të bërë një kërkesë për IM, plotësoj një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e familjes dhe siguroj një dokument nga shërbimi i kontributeve për vitin e kaluar.

Sigurimi i Spitalizimit

Një qëndrim në spital mund të kushtojë shumë shtrenjtë, edhe pse jemi i titulluar i një administrate të sigurimit mjekësor (mutuelle) prandaj, egziston një sigurim spitalizimi që garanton mbulimin e të gjithave shpenzimeve. Shuma e këtij sigurimi varet nga një administratë e sigurimit mjekësor (mutuelle) në një tjetër.

Dokumentat e mutuelit

Mbas regjistrimit, unë marr dokumenta të rëndësishme administrative.

Një fletore shënimesh pjësëparësh (egziston në disa administrata të sigurimit mjekësor (mutuelle), dhe në disa të tjera jo)

Kjo fletore plotëson kartën time të identitetit social, aty gjenden :

- mbiemrat, emrat, ditëlindjet dhe statusi familjar i titullarit dhe personave që ka në ngarkim ;
- numrat e regjistrimit në administratën e sigurimit mjekësor (mutuelle) ;
- nje mendim modifikimi për të informuar administratën e sigurimit mjekësor (mutuelle) për çdo ndryshim adrese ose statusi ;
- informatat e nevojshme si orët e kujdestarëve, numrat e telefonit të shërbimeve…

Pullat

Unë marr gjithashtu pullat në të cilat janë përfshirë të dhënat e mia. ato plotësojnë kartën time të identitetit social dhe janë të kërkuara për shumë shërbime mjekësore (konsultat në spital, analiza e gjakut, kthimi i të hollave për vërtetimet e ndihmave mjekësore).

KAM PRA GJITHMONE KETO PULLA NE PORTOFOLIN TIM.

Vërtetimi i ndihmave të dhëna

Kur paguaj konsultën, ndonjëherë marr një vërtetim të ndihmës mjekësore të dhënë me letër, e cila shërben si provë pagese. Unë ngjis një pullë dhe e lë tek administrata e sigurimit shëndetësor e cila më rimburson një pjesë të shpenzimeve. Po kështu, është e mundur që mjeku t' ia dërgojë direkt vërtetimin në mënyrë elektronike administratës së sigurimit shëndetësor.

KUJDES: TE GJITHA SHPENZIMET MJEKESORE NUK JANE.

Parashkrimi i ilaçeve

Kur mjeku më parashkruan një ilaç, ai shkruan një recetë (parashkrimi i ilaçve). këtë e jap te farmacia edhe.

Në këtë mënyrë, unë paguaj direkt vetëm një pjesë të çmimit të ilaçit. Disa ilaç të ashtuquajtura "të rehatshme" nuk janë të rimbursurara.



Kërkimi i një pune

Kërkimi i punës mund të bëhet vetvetiu. Megjithatë, komunikimi dhe kodet kulturale të vendit luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Pra është e domosdoshme të interesoheni mirë përpara se të veproni: nuk mjafton të keni cilësi të mira, duhet të mundoheni ti vëni në dukje dhe të shpreheni në formën e pritur nga punëdhënësi. Egzistojnë, për këtë, shërbime të specializuara që munden të më orientojnë.

Pyetjet që janë për tu bërë:

	PO	JO	
A mund ti bëj dokumentat e nevojshme ?			Plotësoj dosjen time : barasvlefshmërinë e diplomës, patentën çertifikatën e formacionit vërtetimet, regjistrimin si kërkues pune...
A mund të shprehem qartë për projektin tim profesional dhe kompetencat e mia ?			Realizoj një bilanc të kompetencave, për shembull në Forem, në një organizëm për integrimin social-profesional në një Qëndër Krahinore për Integrimin....
A kam një CV të mirë dhe një letër të mirë të motivimit? cilat janë cilësitë e mia, njohuritë e mija, komptencat e mia? Ai përgjigjen ato nevojave të punëdhënësit?			
A mund të kërkoj vetëm? A kam informacione të mjaftueshme, për shembull për të vendosur nëse dërgoj kandidatura me iniciativën time ose nëse i përgjigjem ofertave të punës?			Marr këshillë pranë FOREM-it , një shtëpi lagjeje, një organizëm për integrimin-social-professionel… ose marr pjesë në një atelier për kërkim pune.
A kam në një takim për punë çfare do të them? Si do të presentohem?			Marr këshillë pranë një organizimi që propozon punecoaching ose ushtrohem në një atelier për kërkim pune.

Kërkimi i një pune

FOREM është një shërbim publik për punën dhe formacionin (kursin) profesional në Wallonie. Në Forem unë regjistrohem si kërkues pune. Në faqen (në internet) e tij www.leforem.be, unë mund të përdor një seri shërbimesh në linjë: oferta pune, formacione, informacion mbi zanatet, sallona të punës. Kur unë jam kërkues pune, këshilltarët ndjeknin dosjen time dhe munden të më orientojnë.

Duke qënë kërkues i (e) punës, duhet të plotësoj një seri detyrimesh sidomos ato të kërkimit me këmbëmgulje të punës. Në qoftëse une marr një ftëse, jam i detyruar të shkoj. Kujdesem që të ruaj të gjitha provat e kërkimeve (për punë) dhe informoj këshilltarin (en) tim(e) për çdo ndryshim në situatën time.

Një tjetër zgjidhje është e deklaruar shumë e frytshme për të gjetur një punë : rrjeti i lidhjeve që bëj rreth meje. Mendohet që një pjesë e madhe e vendeve të punës : gjenden nëpërmjet të tjerëve : rrethi shoqëror, miqitë, familja janë shpesh aleatë të çmuar. Shumë punëdhënës kanë prirje të bëjnë besim një rekomandimi personal.

Midis strategjive të integrimit, gërshetimi i lidhjeve të besimit është pra për tu vëne midis përparësive.

Agjensitë e punëdhënies të përkohshme janë gjithashtu një bashkëbisedues i privilegjuar për disa sektore të veprimtarish (activite). Në belgjik, shumë ndëmarrje janë të prezantuara në Wallonie. Zëvendësi i përkohshëm është i angazhuar nga një agjenci e punëdhënies (që jep punë përkohësisht) për llogarinë e një purëdhënësi që ka nevojë për një punë përkohësisht. Kjo lloj punë siç e kërkon rregullorja dhe zëvendësi i përkohshëm përfiton të njëjtat të drejta si punëtorët e tjerë në çështje me pensionet, pushimet, sigurimet e sëmundjes…

Disa agjensi janë të ndjeshme pyetjeve që lidhen me ndryshimet e kulturave.

Lajmerimet e vogla të publikuara në gazetë, në kutijat (e letrave) dhe në internet janë edhe ato një menyrë klasike për të gjetur punë.

Unë jam megjithatë i(e) vemendshëm (me) të lexoj mirë lajmërimet, të zbuloj punën në të zezë ose mashtrimet. Shmangem për shembull të shkoj në një takim në hotel… Nga kjo pikëpamje, është e preferueshme të konsultoni shtypin e specializuar dhe publikimin e FOREM-it.

Kur e kam përcaktuar profilin tim, projektin tim professional dhe kompetencat e mia, une mundem ti dërgoj punëdhënësit një kandidature me iniciativën time .Për aq sa kërkimi dhe komunikimi të jenë në shenjë të mirë, kjo strategji është konsideruar si një nga më të frytshmet.

Më në fund, shumë organisme të integrimit socail-profesional (OISP), shoqata të ndryshme, shtëpija të lagjes, administrat e lagjes proposojne shërbime shoqëruese për zhvillimin një strategjie të mirë për kërkimin e punës. Në qoftëse nuk i përdor aparatet e ndërlikuara të ushtrimit, nuk hezitoj t'ju bëj thirrje kompetencave të tyre.

Njëvlërsimi i diplomave

Për shumicën e diplomave të huaje, njëvlerësim duhet kërkuar pranë shërbimit të Njëvlerësimit të Komunitetit Françez.

Kujdes, procedura për njohjen e diplomës është e gjatë dhe kërkon përbërjen e një dosje të hollësishme që i përgjigjet kërkesave te sakta.

Lidhje e nevojshme : www.equivalences.cfwb.be 02 690 86 86

Diskriminimi në takimet për punë është e ndaluar dhe e dënueshme nga ligji.

Kur është vërtetuar një diskriminim, ai mund të denoncohet. UNIA (Qendra Ndërfederale për Shanse të Barabarta) është një shërbim publik i pavarur, misioni ligjor i të cilit është të promovojë barazinë dhe luftën kundër diskriminimit. Ai mund të veprojë në emër të një personi të diskriminuar.Në rast problemi, mund të këshillohem nga shërbimet e tij: linja jeshile falas në numrin e mëposhtëm 0800/12800 ose unia.be

Kontrata e punës

Në Belgjik, puna është siç e kërkon rregullorja në një mënyrë të ndryshme sipas sektoreve. Flasim në përgjithësi për sektorin privat, sektorin publik, sektorin tregtisë, sektorin (që nuk ka për qëllim fitimin). Në veçanti, çdo sektor (për shembull sektori i ndërtimit) është rregulluar nga një <<komision që përcakton kushtet e punës.

Puna nënkupton që atëherë një kontratë pune. Është një angazhim i ligjshëm që lidh dy palët të paktën dhe që krijon të drejta edhe detyrime. Palët janë zakonisht të quajtura << punëdhënësi >> dhe << punëtori >> (ose << nëpunësi>>).

Kontrata e punës kur bëhet, për të dyja palët ka detyrime (orari, puna, rroga, pushimet,...). punëdhënësi dhe punëtori duhet të kënë respekt dhe përfillje të dyanshme. Ato duhet të sigurojnë dhe të vëzhgojnë respektin e mirësjelljes dhe veprimet e mira gjatë zbatimit të kontratës.

Egzistojnë disa lloje kontratash: të plotë, kontratë të pjesshme, zevëndësimi, (punëdhënësi është agjencia që jep punë përkohësisht) me zgjatje të përcaktuar, (CDD = datat e fillimit dhe e mbarimit janë të shënuara në kontratë), me zgjatje të papërcaktuar (CDI = zgjatje e kontratës nuk është e përcaktuar)...

Kur punëdhënësi ose punëtori dëshiron ti japë fund kontratës një periudhë palalajmërimi është parashikuar nga rregullorja një afat minimum respektohet para se ta lini punën. Ky afat që duhet respektuar varet sipas situatës dhe tipit të kontratës.

Pra gjithmonë, unë sigurohem të nënshkruaj një kontratë në formë të mirë dhe të rregullt. për një përvojë të parë ose në rast dyshimi ; marr këshillë pranë një sindikate që mbron intersant e punëtorëve, pranë FOREM-it ose pranë një shërbimi social.

Qasja në tregun e punës

Leja e punës

Puna e punëtorëve të huaj është përveç kësaj e rregulluar nga ligji i 30 prilit 1999 nga vendimi mbretëor i 9 qershorit 1999 (persa i përket atyre me rroge) rregullat në çështje me hyrjen në tregun e punës të punëtorëve të huaj, si dhe rregullat në çështje me marrjen e një titulli të qëndrimit janë të ndërlikuara.

Që nga viti 2019, leja e qëndrimit tregon nëse kam apo jo të drejtë për të punuar.

Nëse mund të punoj, kjo tregohet në lejen e qëndrimit:

- « Tregu i punës : Qasje e kufizuar ": Kam të drejtë të punoj për një punëdhënës të vetëm për një funksion të vetëm, ai që ka marrë autorizimin për të më punësuar kur kam bërë kërkesën për lejen e vetme.

OSE

- « Tregu i punës : Qasje e pakufizuar ": Kam të drejtë të punoj për çdo punëdhënës për të gjitha profesionet me rrogë. Asnjë formalitet shtesë nuk duhet të kryhet.

Nëse nuk kam të drejtë të punoj, aty shkruhet "Tregu i punës: jo".

Adresa që ju nevojiten

SPW — D6 operativ i Ekonomisë, të Punës të Kërkuar

Departamenti i Punës dhe i Kursit Profesional

Drejtorie e punës dhe leja e punës

Place de Wallonie, 1 — bâtiment 2

5100 Jambes

Puna e pavarur

Për të qenë i vetë punësuar (pra, për të qenë vetë shef), çdo person që nuk ka nënshtetësi belge duhet të marrë një kartë profesionale pranë një zyre biznesi.

Disa kategori të huajsh janë megjithatë të përjashtuar:

- shtetasit e 25 vendeve të Bashkimit Evropian dhe disa pjësëtare të familjes së tyre që bashkohen me ta;
- refugjatët e njohur dhe titullarët me një qëndrim të pakufizuar;
- bashkëshortja e një Belgu dhe disa pjësëtare të familjes që bashkohen me ta;
- bashkëshortët që ndihmojnë burrin ose gruan në veprimtarië e pavarur (privat);
- personat që udhëtojnë për biznes, konferencierat, gazetarët, spartivat, artistat nëse zgjatja e qëndrimit nuk i kalon tre muaj rrjesht;
- studentat e huaj që bëjnë praktikën në kuadrin e studimeve të tyre.
- ...

Tjera kushte duhet të plotësohen: disa profesione që janë sipas rregullores.

Për një aktivitet që kërkon regjistrimin në regjistrin tregtar ose artizanal, është e nevojshme të provohet njohuria e menaxhimit. Nëse është e nevojshme, unë mund të jap një provim pranë Shërbimit të Jurisë Qendrore.

Disa profesione kërkojnë provën e **njohuritë profesionale** dhe/ose të diplomave.

Për shumicën e diplomave të huaja, një barasvlefshmëri duhet të njihet dhe të kërkohet pra, pranë Shërbimit të Barasvlefshmërisë të Komunitetit Francez.

Puna e pavarur

Detyrimet administrative duhet të plotësohen , kryesisht :

- Pjesëmarrësi i një arke të sigurimeve shoqërore (të hollat që paguhen për çdo trimestër).
- Kërkoni një numër të ndërmarrjes në sportelin e ndërmarrjes zyrtare
- kërkoni një regjistrim në regjistin e tregtisë, 'me përjashtim të disa profesioneve ; profesione liberale, bujqësore).
- Deklarimin e veprimtarisë në TVA (plotësoni një deklaratë dhe paguani shumat që iu detyroheni çdo trimester (me përjashtim të disa veprimtarive: aktor, këngëtar, modele, disk-jackeys, profesione liberale) .
- Te hapin një numër llogarie të veçantë për vërprimtarinë e pavarur (private).
- Të mbani një llogaritje në formën e duhur dhe të mirë. është e këshilluar të rrethoheni nga shërbimet e një llogaritari.
- Të jeni pjesëtar i një mutueli. (institucioni që rimburson shpenzimet mjekësore, etj ..)
- Të paguani taksat (tatimet), sipas një deklarate vjetore

Faqe e nevojshme :
https://economie.fgov.be/fr/themes/entreprises/creer-une-entreprise/les-conditions-dacces-la

Puna në të zezë (e pa deklaruar)

Puna që nuk është e deklaruar është quajtur puna ne të zezë. Është nje veprimtari me rrogë, por e pa deklaruar pushtetit publik. Ajo i shpëton kështu të gjithave rregullave të solidaritetit të drejtësisë belge, (taksat, të hollat për sigurimet shoqërore) dhe është pra e dënuar nga ligji.

Shembull: Komshija ime më propozon të shkoj të lyej në shtëpinë e saj dhe më paguan 5 euro/në orë.

Gjatë punës në të zezë, nuk ka kontrate të punës së ligjshme. punëdhënësi gjasmë nuk i plotëson detyrimet e tija në çështje me sigurimet shoqërore dhe sistemit të tatimeve. Rreziqe të mëdhaja peshojnë për ketë lloj pune dhe mund të kenë pasoja të rënda për punëdhënësin edhe për punëtorin.

- Pa kontratë pune, rrezikoj të mos paguhen plotësisht ose pjësërisht (harresë e orëve shtesë të bëra për shembull. Mashtrimet dhe zhgënjimet janë të shumta.
- Unë nuk kam asjnë lloj të drejte në çështje me sigurimet shoqërore (pa aftësi për punë, materniteti, invalid, vdekje, pension , dhe papunësi). Në rast aksidenti nuk jam i mbrojtur. Pra asnjë sigurim dhe asnjë ankesë.
- Punëdhënësi mund të kërkojë nga unë ç'farë të dëshirojë : të punoj me një rrogë më të vogël se rroga e ligjshme, të punoj më shumë që zgjatja (e orëve të punës) e ligjshme, të më heqë nga puna kur të dëshirojë....
- Nesë kam një ndihmë të asistencës (chomage-it) ose të CPAS-it mund të jeni i sanksionuar, i përjashtuar ndoshta të jem i detyruar të rimbursoj ndihmat (në të holla) e marra padrejtësisht.
- Denuncimet dhe kontrollet janë të shpeshta dhe si pasojë gjoba dhe sonksionime të tjera.

